



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 10926/2019  
Data: 11.11.2019

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e dhjetë -X- për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 22.10.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie, Sociale), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ilir Kaloshi (Përfaqësues i Kompanisë Pastrimi), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Përfaqësuesi i OSB-së . Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2019.
3. Shqyrtimi i propozim ndryshimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
4. Shqyrtimi i propozim rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët.
5. Shqyrtimi i planit financiar i N.P.L “Pastrimi” sh.a për vitin 2020.
6. Shqyrtimi i informatës për raportin e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2018/2019 në SHFMU dhe SHML.
7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për nëntëmujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**



## 2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2019.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** buxheti i komunës për vitin 2019 është në lartësi prej 2,915,921.00 Euro, ndërsa ai përfundimtar është 3,205,548.08 Euro. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-shtator 2019 është në shumë prej 1,785,303.16 € apo 55.69 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,105,197.48 € apo 74.25 %, për mallra dhe shërbime 169,648.58 € apo 64.72 %, për shpenzime komunale 33,183.68 € apo 61.00 %, për subvencione dhe transfere 55,783.80 € apo 84.21 % dhe për shpenzime kapitale 421,489.62 € apo 31.70%. Të hyrat vetanake për këtë periudhë nëntëmujore 2019 janë realizuar në shumë prej 241,740.21 € apo për 15,206.13 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2018. Shpenzimi për këtë periudhë nëntëmujore 2019 është realizuar në shumë prej 1,784,803.08 Euro apo për 281,455.90 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te të hyrat vetanake është një rritje dhe kërkoj sqarim për shkak se po rriten për çdo vit dhe në një mbledhje ka qenë se po barten këto dhe nuk e di a po e përfshini bartjen te rritja apo po e ndani veç rritjen se është pak diskutabile. Te mirëmbajtja e varrezave një punëtoare që është për gjashtë muaj si është sistemuar dhe pagesa si bëhet a bëhet mujore apo bëhet e përgjithshme për gjashtë muaj? Shpenzimet po shihen që janë rritur në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe pse këto shpenzime ndodhin sikur tash te këto subvencione dhe transfere ta zëmë i ke diku 16,000 € më shumë shpenzime edhe pse ke dhënë disa sqarime por megjithatë ka një lloj dileme për sqarim pse këto rritje kështu bëhen.

**Nora Ballazhi** thekson:- çka ka ndikuar te rritja e buxhetit ? A ka ndikuar vetëm tatimi në pronë apo ka ndonjë donacion? Te mallra dhe shërbime shuma që kalohet mbi 10,000 € a janë mallra dhe shërbime apo investime kapitale. Me sa jam e informuar që shumat të cilat kalojnë mbi 10,000 € ishin investime kapitale ndërsa shumat nën 10,000 € ishin mallra dhe shërbime.

**Teuta Shkreta** thekson:- mëditjet dhe udhëtimet zyrtare jashtë vendit kanë të bëjnë me mëditjet e udhëtimit zyrtarë në Shqipëri, Mal të Zi, Itali. Cilës drejtori i takojnë këto? A nuk është e specifikuar kush përfshihet në këtë mëditje më hollësisht?

**Shabi Rexhallari** thekson:- te rritja apo bartja, bartja është e veçantë që është bërë për këtë shumë dhe është përfshirë në buxhet, ndërsa te rritja e të hyrave kemi pasur planin 289 000 € kemi realizuar 241,000€ ndërsa vjet për nëntë muaj ka qenë 226,000 € tash krahasimi i bie për 15,206 euro më shumë kemi inkasuar. Kjo ka ndikuar se kemi pasur disa të hyra të paplanifikuara, të hyra nga konfiskimet, të hyra nga shitja e pasurisë që i kemi shitur disa vetura të komunës. Të tjerat si rritje ka ndikuar te zhvillimi ekonomik te bizneset, vjet të hyrat nga bizneset kanë qenë 60,258 €, ndërsa në këtë vit për nëntë muaj 75 000 € që është një diferencë, tash nëse e marrim krahasimin te tatimi në pronë vjet kanë qenë 95,000 € të inkasuara në këtë vit kemi 85000€. Lejet ndërtimore vjet 3717 € në këtë vit kemi 7129 €. apo te të hyrat e dënimeve në trafik vjet kanë qenë 24715 € në këtë vit kemi 17,525 €. Nëse e shikomë raportin në faqe 21 krejt shihen këto diferenca që janë në kuadër të këtij raporti për mos me hy në detale për secilën. Te pagesa mujore e mirëmbajtjes te varrezat e dëshmorëve është paguar për çdo muaj, diku 406 euro neto por paguhen edhe kontributet , është sistemuar me kontratë të veçantë. I kemi paraqitur në faqe 14 apo 15 shërbimet kontraktuese tjera. Te mallra dhe shërbime varet se çfarë shërbime nëse ne e paguajmë transportin 10,000 €, 20,000 €, 30,000 € nuk do të thotë me kaluar në investim kapital sepse është shërbim ose te karburantet nëse kalon 10,000 apo 20,000 € është shërbim.



**Teuta Shkreta** thekson:- te shpenzimet shëndetësore është bërë shpenzim për analizat e ujit kërkoj sqarim se në cilat vende janë bërë?

**Medina Imishti** thekson:- janë bërë analizat e ujit të pijshëm diku 7 pika dhe kalojnë në Drejtorinë e Shëndetësisë. Kanë qenë 7 pika për një kohë pastaj edhe disa të tjera kemi pas me i bë analizë. Po janë raportet, nëpër kroje publike ku janë bërë analizat.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR – SHTATOR 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**3. Shqyrtimi i propozim ndryshimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- siç dihet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka nxjerrë një udhëzim administrativ sipas të cilit është një ndryshim i rregullimit të organizimit të fshatrave në territorin e komunës në bazë të numrit të banorëve. Në territorin e komunës tonë ne klasifikohemi në kategorinë e komunave që i kanë deri në 10,000 € banorë të cilat duhet t'i formojnë katër këshilla të fshatrave. Unë iu kam dorëzuar një propozim dhe ne si komunë e kemi bërë këtë propozim dhe jemi shumë fleksibil në qoftë se ndonjë lagje ose ndonjë fshat dëshiron t'i bashkëngjitet dikujt tjetër dhe qëllim themelor i yni me këtë propozim ka qenë që shtrirja gjeografike të përfshijë këto lagje . Ne kemi Seçishta e Kriveniku është një këshill lokal, pastaj këshilli i dytë lokal është Goranca dhe Rezhanca, këshilli i tretë lokal është Paldenica, Dermjaku dhe dy vendbanimet që nuk kanë banorë por ekzistojnë si vendbanime ndërsa kemi pasur problem me këto lagjet që e rrethojnë Hanin e Elezit, kemi pasur nga pak problem me fshatin Pustenik se ekziston si Pustenik por është i pabanuar dhe normal me Laç. Hani i Elezit është zonë urbane dhe një pjesë e lagjeve do të hyjnë në zonën Urbane të Hanit të Elezit që do të përfshinë, Lagja e Re, Lagja Melqi, Lagjësja e Ujit të Thartë, Pustenik dhe Dimca. Kemi dhënë edhe propozimin se si do të përfaqësohen dhe secila lagje dhe secili vendbanim do ta këtë përfaqësuesin e vetën në këshillin e fshatrave. Përfaqësuesit e këshillave lokale të fshatrave do të paguhen sikur anëtarët e komiteteve konsultative. Materialin e kemi pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo propozim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- përcaktimi i lagjeve dhe fshatrave a është në bazë të zonave kadastrale apo në bazë të ndonjë kriteri tjetër për shkak se nëse potencohet Lagjja e Re cila pjesë e përfshinë, apo fshati Pustenik apo fshati Dimca për shkak se nuk është shumë e sqaruar.

**Mallzum Qajani** thekson:- nëse shkohet përmes zonës kadastrale Lagjja e Re duhet të shkon me fshatin Seçishtë dhe Lagjja e Ujit të Thartë ka pjesë që shkojnë në Pustenik dhe ka pjesë që shkojnë me Kaçanik. Duke pasur për bazë shtrirjen e këtyre lokaliteteve nuk kemi shkuar sipas zonave kadastrale por sipas shtrirjes gjeografike.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë me i definuar për shkak se nëse shkohet në këtë mënyrë e ke të pa definuar rajonin gjeografik.

**Kryesuesi** thekson:- mënyra e përzgjedhjes ndoshta do të jetë problem duke u bazuar në zgjedhjet të cilat janë mbajtur dhe nuk kemi pasur numër të përkufizuar ata të cilët kanë marr vota më shumë janë zgjedhur , mirëpo mënyra e përfaqësimit që është propozuar mund të jetë problem për shkak se ndonjë fshat apo lagje mund të merr më pak vota.

**Mallzum Qajani** thekson:-nëse në rregullore precizohet se në fshatin Seçishtë dhe Krivenik duhet të përcaktohet ky numër i anëtarëve të këshillit zgjidhen personat të cilët janë më të votuarit.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PROPOZIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIME DHE LAGJE URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**4. Shqyrtimi i propozim rregullore për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,

**Medina Imishti** thekson:- koalicioni i organizatave për mbrojtjen e fëmijëve ka hartuar një rregullore unike për të gjitha komunat. Së bashku me komisionin për hartimin e rregulloreve e kemi plotësuar dhe e rëndësishme në këtë rregullore është mekanizmi koordinues për të drejtat e fëmijëve. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PROPOZIM RREGULLORJA PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT TË QEVERISËS KOMUNAL MIQËSORË PËR FËMIJËT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**5. Shqyrtimi i planit financiarë i N.P.L” Pastrimi” sh.a për vitin 2020.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Illir Kaloshi** thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka konkrete nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA PLANI FINACIAR I NPL PASTRIMI SH A PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**6. Shqyrtimi i informatës për raportin e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2018/2019 në SHFMU dhe SHML.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- jemi munduar në pika të shkurtra me paraqitur një raport dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA INFORMATA PËR RAPORTIN E DKA-së MBI SUKSESIN E ARRITUR PËR FUNDIN E VITIT SHKOLLORË 2018/2019 NË SHFMU DHE SHML QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**



**7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për nëntëmujorin e N.P.L Pastrimi sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Ilir Kaloshi** thekson:- raporti financiar është paraqitur në mënyrë tabelare dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

**U VOTUA INFORMATATA MBI RAPORTIN FINACIAR PËR NËNTË MUJORIN E NPL PASTRIMI SHA QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**8. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Teuta Shkreta** thekson:- kontroll kemi pasur nëpër shkolla dhe më është dukur mirë por është mirë që t'u kushtohet rëndësi pastrimit të banjove në shkollën fillore "Ilaz Thaçi" dhe paralelen e ndarë në Krivenik.

**Menduh Vlashi** thekson:-te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" është problem për shkak se është numër i madh i nxënësve por edhe numri i vogël i punëtorëve. Këtë çështje e kam diskutuar edhe me drejtorin e shkollës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- para disa dite ka ndodhur një aksident te rruga e cila vjen prej fshatit Gorancë dhe një fëmijë ka humbur jetën dhe si kuvend ndjejmë keqardhje por ekzekutivi është mirë që të merr masa për çështjen sepse përsëri është rrezik. Për këtë çështje kemi diskutuar edhe më herët por deri më tani nuk është ndërmarrë ndonjë veprim.

**Nora Xhoni** thekson:- kërkesë kam nga banorët që të bëhet ndriçimi edhe ka shtëpia e z.Bedri Luri.

**Refet Kalisi** thekson:- vitin e ardhshëm do të bëhet ndriçimi ka ajo pjesë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:01

**Procesmbajtësi**

**Ayni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Msc. Qamush Brava**

